

FONDET E BE-së PËR SHOQËRI CIVILE

Ngritja e fondeve është procesi përmes së cilit një OShC i qaset fondeve të nevojshme për ti zbatuar aktivitetet e organizatës. Ngritja e fondeve ka kuptime të ndryshme, mirëpo më së shpeshti i referohet mbledhjes së fondeve nga donatorë të ndryshëm. E përkufizuar në këtë mënyrë, ngritja e fondeve i referohet të gjitha aktiviteteve që ndërmerren nga një OShC për ti siguruar burimet e duhura për ta përmbushur misionin e vet.

CILËT JANË DONATORËT KRYESOR NË KOSOVË QË PËRKRAHIN SHOQËRINË CIVILE?

Duke u bazuar në nevojat dhe fazat e tranzicionit nëpër të cilat po kalon Kosova, edhe niveli i përkrahjes dhe prioritet e donatorëve kanë ndryshuar. Në periudhën e pas luftës kryesisht përkrahja ka shkuar në drejtim të rindërtimit, strehimit dhe nevojave humanitare. Pas shpalljes së pavarësisë në kryesisht përkrahja synon ndërtimin dhe zhvillimin e demokracisë, ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve, sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, ndërtimin e

shtetit dhe përkrahjen e agjendës për integrim europian të Kosovës. Aktualisht, ndër donatorët kryesorë për shoqërinë civile në Kosovë radhiten: Bashkimi Europian, USAID, Fondacioni SOROS (KFOS), Ambasada Norvegjeze, Zyra Zvicrane për Bashkëpunim (SCO-K), SIDA, Ambasada Holandeze, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, ambasadat tjera të vendeve të BE-së dhe disa donatorë tjerë rajonal dhe europian që mbulojnë edhe Kosovën.

CILAT JANË PROGRAMET E ASISTENCËS FINANCIARE TË BE-SË PËR KOSOVËN?

Asistenca financiare e BE-së në dispozicion për vendet e Ballkanit Perëndimor përbëhet nga: 1) Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA); 2) Instrumenti Europian për të Drejta të Njeriut dhe Demokraci (EIDHR); 3) Programet komunitare të BE-së si TAIEX, Twinning dhe P2P; 4) Programi për Mësim Jetësor (Life Long Learning); 5) Rinia në Veprim (Youth in

Action); 6) Europa për qytetarët (Europe for Citizens); 7) Tempus e programe të tjera. Këto janë një seri e instrumenteve financiare të miratuara nga Komisioni Europian të cilat synojnë përafrimin e këtyre vendeve drejt BE-së, fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve kandidate/potenciale kandidate dhe financohen nga buxheti i përgjithshëm i Komunitetit Europian. Shtetet potenciale kandidate për BE, sikur që është Kosova, marrin pjesë në disa programe komunitare varësisht nga kushtet dhe kundrejt një pagese për anëtarësim ose bashkëfinancim. Për momentin Kosova përfiton nga programet e asistencës së BE-së IPA, Instrumenti EIDHR, programet e TAIEX-it, Twinning dhe P2P si dhe programi TEMPUS.

CILAT JANË PRIORITET E IPA-SË PËR KOSOVËN?

Asistenca e BE-së në Kosovë është e paraparë për zhvillimin e shoqërisë demokratike dhe moderne, duke u bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Përkrahja për ngritjen e kapaciteteve institucionale, fuqizimin e sundimit të ligjit dhe disa sektorë të ekonomisë janë vetëm disa prej fushave prioritare programore për Kosovën. Prioritet kryesorë të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA) të Bashkimit Europian kryesisht ndërlidhen me veprimet për t'i ndihmuar Kosovës të ballafaqohet me sfidat e integritimit europian, për të zbatuar reformat e kërkuara të përcaktuara në procesin e Stabilizim Asociimit (pSA) dhe për t'i shtruar themelet për plotësimin e kritereve të Kopenhagës për anëtarësim në BE. IPA 1 ka mbuluar qarkun buxhetor për vitet 2007-2013, derisa IPA 2 do të mbulojë vitet 2014 - 2020. Mesatarisht asistenca vjetore e BE-së për Kosovën është rreth 60 milion EUR.

ÇKA NËNKUPTOJMË ME KAPACITETE PËR NGRITJE TË FONDEVE?

Duke mos pasur të ardhura të vazhdueshme nga një burim i vetëm, karakteristikë e veçantë e sektorit civil është nevoja për ngritje të vazhdueshme të fondeve dhe përdorimi i tyre për të zbatuar misionin e organizatës. Aktiviteti që ushtrojnë OShC-të për të përgatitur kuadrot e tyre me qëllim të mbledhjes së fondeve nga donatorë të ndryshëm për të ushtruar veprimtarinë e tyre njihet me termin kapacitete për ngritjen e fondeve.

ÇKA ËSHTË IPA-INSTRUMENTI I PARA ANËTARËSIMIT?

Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA) është mekanizëm financiar i Komisionit Europian që përkrah vendet në kuadër të politikës së zgjerimit të Bashkimit Europian. Ky instrument financiar kryesisht përkrah projekte nga tri kategori të mëdha: kriteret politike, kriteret ekonomike dhe standardet europiane.

CILAT FUSHA PËRKRAHEN NGA EIDHR?

Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në vendet candidate dhe candidate potenciale për anëtarësimin në BE. Puna e tyre luan një rol kyç në mbarëvajtjen dhe cilësinë e procesit të pranimit, si dhe gjenerimit të përkrahjes publike për anëtarësimin. Përgjegjësia për forcimin e rolit dhe ndikimit të shoqërisë civile bie së pari mbi vet Kosovën. Megjithatë, Komisioni

European jep ndihmën e tij për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Përveç rritjes së ndjeshme të ndihmës financiare për projektet mbi shoqërinë civile nën IPA, Komisioni European ka në dispozicion edhe Instrumentin European për Demokraci dhe të Drejtat e njeriut (EIDHR). Ky instrument ka komponentën financiare nga e cila përkrahen projektet që mbrojnë dhe promovojnë demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Që nga viti 2008 EIDHR përkrah OShC-të në Kosovë përmes granteve. Buxheti i EIDHR për vitin 2013 është rreth 1 milion EUR.

ÇKA ËSHTË INSTRUMENTI EUROPIAN PËR DEMOKRACI DHE TË DREJTAT E NJERIUT (EIDHR)?

EIDHR është një instrument i BE-së në përkrahje të demokracisë që ka për qëllim të sigurojë mbështetje për promovimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut në vendet jashtë BE-së, duke përfshirë edhe Kosovën.

ÇKA ËSHTË PROGRAMI PËR PËRKRAJË TË SHOQËRISË CIVILE (CIVIL SOCIETY FACILITY)?

Instrumenti më i ri përmes të cilit Zyra e BE-së programon fondet IPA në Kosovë quhet **Programi për përkrahjen e shoqërisë civile** (Civil Society Facility). Programi për përkrahjen e shoqërisë civile është një program i Komisionit Evropian i cili mbështet zhvillimin e shoqërisë civile për të qenë pjesë aktive në debate publike për demokraci, të drejta të njeriut, përfshirje sociale dhe sundim të ligjit, dhe ndërton kapacitetin e tyre për të ndikuar në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse.

Përkrahja financiare për sektorin e shoqërisë civile gjatë vitit të fundit është 1.1 milion EUR dhe zbatohet përmes 5 projekteve të cilat kanë filluar së zbatuari në dhjetor 2012. Projektet zbatohen nga **Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile** (KCSF), **Iniciativa për Zhvillim të Bujqësisë në Kosovë** (IADK), **Qendra Evropiane për Çështje Minoritare** (ECMI), **Saferöorld** dhe **Ëorld Vision**. Këto projekte do të mbështesin përpjekjet e shoqërisë civile në krijimin e kushteve të nevojshme për një dialog konstruktiv, sistematik dhe efikas, dhe një partneritet në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare në të gjitha nivelet e qeverisjes, si dhe përpjekjet në fuqizimin e ndikimit të të rinjve në politik-bërje dhe vendimmarrje që ndërlidhen me zhvillimin socio-ekonomik dhe përfshirjen e tyre në procesin e integritit në BE. Skema e re për grante e këtij programi për Kosovë lansohet përmes thirrjeve për propozime. Të gjitha informatat e nevojshme do jenë në dispozicion në uebfaqen e Zyrës së BE-së në Kosovë: <http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo>.

KUSH MUND TË JETË PËRFITUES I INSTRUMENTIT EIDHR?

Përfitues të EIDHR mund të jenë të gjitha organizatat e shoqërisë civile, organizatat jo-fitimprurëse publike dhe ato të sektorit privat, organet shtetërore, rajonale dhe ndërkombëtare, organizatat ndërqeveritare ndërkombëtare dhe ato rajonale si dhe personat fizik, kur ndihma e tyre është e nevojshme për arritjen e qëllimeve të EIDHR-së.

Duke njohur faktin që jo vetëm organizatat jo-qeveritare të regjistruara (OJQ-të) bëjnë pjesë në shoqëri civile, termi OShC u referohet të gjitha formave të organizuara të shoqërisë civile. Termi OJQ, në këtë dokument, përdoret vetëm në rastet kur flitet për dispozitat konkrete ligjore të cilat u referohen konkretisht organizatave jo-qeveritare të regjistruara (OJQ-ve).

ORARI I PUNËS
 e hënë – e premte
 10:00 deri 14:00



Qendra ofron si dhe i përgjigjet çdo kërkesë për informacion për nevojat e organizatave të shoqërisë civile (OShC), qytetarëve të interesuar, institucioneve publike dhe organizatave donatore për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

QËLLIMI I QENDRËS:

- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e vendit
- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes
- Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit rreth sektorit të shoqërisë civile
- Krijimi i instrumenteve për mbledhjen dhe analizën e vazhdueshme të të dhënave për sektorin e shoqërisë civile dhe fusha të veçanta të këtij sektori
- Ngritja e kapaciteve të OShC-ve dhe institucioneve publike për bashkëpunimin ndërsektorial
- Promovimi dhe përkrahja e drejtpërdrejtë në qeverisjen e mirë të brendshme të OShC-ve

ÇKA OFRON QENDRA?

- **Deskun e informacionit** i cili i përgjigjet çdo kërkesë për informacion rreth sektorit të shoqërisë civile dhe pranon kërkesat e OShC-ve për trajnime, përkrahje dhe mentorim
- **Trajnime bazike dhe të avancuara** për pjesëtarët e OShC-ve, në baza të rregullta ose në bazë paraqitjes së kërkesës nga ana e OShC-ve
- **Shërbimin e këshillimit gjatë punës dhe mentorimit** që ofron këshillim dhe mentorim në punën e përditshme të OShC-ve në bazë të kërkesës së tyre
- **Këndin e informacionit** ku vizitorët mund të marrin informata rreth sektorit të shoqërisë civile dhe broshura e artikuj informues për këtë sektor
- **Këndin e leximit** që mund të presë deri në 10 vizitorë
- **Këndin e bibliotekës** ku vizitorët mund të gjejnë libra dhe artikuj nga fusha e zhvillimit të shoqërisë civile dhe procesit të integritimit evropian
- **Sallën** e pajisur me të gjitha elementet me kapacitet deri në 25 persona

CILAT JANË RREGULLAT PËR VIZITORË?

Broshurat dhe fletushkat jepen falas për të gjithë vizitorët

Librat, buletinët dhe publikimet tjera mund të lexohen vetëm brenda Qendrës

Të gjithë të interesuarit për shërbimet e Qendrës duhet të kontaktojnë deskun e informacionit, me shkrim apo drejtpërdrejtë